



---

**VENDIM**  
**Nr. 72 Datë 11.10.2010**

**PËR**  
**FILLIMIN E PROCEDURAVE TË SHQYRTIMIT TË APLIKIMIT TË**  
**OST SH.A PËR MIRATIMIN E PLANT TË INVESTIMEVE TË VITIT**  
**2011**

Në mbështetje të neneve 9 dhe 24, të Ligjit Nr. 9072, datë 22.05.2003, “Për Sektorin e Energjisë Elektrike”, të ndryshuar, nenit 9 të Rregullores për Procedurat e Paraqitjes dhe Miratimit të Planit të Investimeve nga të Liçensuarit në Sektorin e Energjisë Elektrike, Bordi i Komisionerëve të Entit Rregullator të Energjisë (E.R.E), në mbledhjen e tij të datës 11.10.2010, pasi shqyrtoi kërkesën e shoqërisë OST sh.a dhe u njoh me relacionin e përgatitur nga grupi i punës,

**Konstatoi se:**

Aplikimi i OST sh.a për planin e investimeve për vitin 2011 përmbush përgjithësisht detyrimin e paraqitjes së aplikimit në zbatim të Rregullores për Procedurat e Paraqitjes dhe Miratimit të Planit të Investimeve nga të Liçensuarit në Sektorin e Energjisë Elektrike.

Për gjithë sa më sipër Bordi i Komisionerëve,

**Vendosi :**

1. Të fillojë procedurat për shqyrtimin e aplikimit të OST sh.a për miratimin e plant të investimeve të vitit 2011.
2. Ngarkohet Drejtoria Juridike dhe e Mbrojtjes së Konsumatorit për njoftimin e OSSH Sh.a.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

Ky vendim botohet në Fletoren Zyrtar

**KRYETARI I ERE-s**  
**Bujar NEPRAVISHTA**

